



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL

### I MBLEDHJES SË TETË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 28.09.2017 (e Enjte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: Kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu; këshilltarët e Kuvendit: Sami Demelezi, Zekrija Zuka, Nexhat Aliu, Xhilsime Qamili, Ali Bajrami, Adnan Imeri, Vjollca Kadolli - Halili, Nuredin Lutfiu, Ajtene Frangu, Bekim Azizi, Samet Idrizi, Taib Alidema, Hyse Rama, Visar Demiri, Sejdi Emini, Bislim Bislimaj, Baki Nebiu Daut Xhemajli, Selvije Rexhepi, Vjollca Sylejmani, Ekrem Abazi, Mirlinda Sadiku, Vehbi Rama, Majlinda Ostrogllava, Besjana Rexhepi, ndërsa në mbledhje mungoi, Arbëresha Ibrahimimi. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesja e Zyrës Ligjore, përfaqësuesi i Zyrës për Integritet Evropian, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 26 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e tetë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes, nënkryetarin e Komunës, z.Hasan Aliu, juve të respektuar Këshilltar komunal, Drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, mediat e shkruara dhe të gjithë të tjerët që janë prezent. Meqenëse se po e konsideroj që është seanca e fundit për këtë mandat, me lejoni të ju falënderoj të gjithëve pa dallime për një rrugëtim të përbashkët katërvjeçar. Falënderoj kryetarin, nënkryetarin e komunës, bordin e drejtorëve, organizatat e ndryshme të cilat na kanë ndihmuar në aspekte ne ndryshme. Me që jemi në fushat zgjedhore, unë ju uroj suksese të gjithë kandidatëve që janë në garë dhe ju uroj që ta bëjnë një garë fer. Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës, nëse ka dikush të parashtoj pyetje ose propozime, fjala është për ju, urdhëroni.

**znj.Mirlinda Sadiku:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Pasi që është seanca e fundit, sinqerisht ju kërkoi falje nëse dikujt ua kam lëndu ndjenjat në një formë apo tjetrën, nuk e kam bërë me qëllim që me e ofendu ose diçka, mirëpo qëllimi ka qenë gjithëherë me luftu për qytetarin, për atë që ma ka marr mendja që është e drejtë. Gjithsesi ju dëshiroj suksese, fitorja më e madhe do të

ishite që zgjedhjet të jenë fer e demokratike, keni marr njoftimin edhe përmes mediave, e ku edhe ne anën zyrtare me shkresë ju kam drejtuar kryesuesit, që i jam bashkangjitur subjektit politik të VV-së. Pyetjet për këtë seancë. Sipas aktiviteteve të Prokurimit është bërë furnizimi dhe vendosja e shenjave të komunikacionit. Në planet e prokurimit ka qenë më 15.03.2017, vlera ka qenë 9 mijë e 770 euro. Më intereson ta di pse nuk janë bërë zëbrat përreth shkollave? Në fshatin Skifteraj asnjëherë nuk janë vendosur, te shkolla e Pozharanit nuk ka pas. Nëse është nda ai fond që e ceka me lartë, pse nuk janë vendosur ato shenja sipas planit të prokurimit, që është publiku në faqen zyrtare me 01.06.2017? Është bërë dezinfektimi i objekteve shkollore, shuma 9 mijë e 90 euro, cilat janë ato objekte që janë dezinfektu?

**z.Nuredin Lutfiu:** Përshëndetje të nderuar koleg! Kam një kërkesë nga banoret e fshatit Skifteraj, Stubëll e Ultë, Goden dhe Stubëll e Epërme. Rruga e cila lidh këto fshatra është në gjende tejet të dobët. Këto fshatra kërkojnë që kjo rrugë të asfaltohet.

**z.Bislim Bislimi:** Përshëndetje për të gjithë! Unë dashta ta përkujtoj këtë ditë të rënies heroike të këtyre dy vëllezërve, është mirë ne si Kuvend me mbajtur një minut heshtje.

**z.Naim Pira Kryesuesi:** Komuna dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka organizuar manifestimin i cili është njoftu edhe përmes uep faqes e mjeteve elektronike, por megjithatë ne e mbajmë një minutë heshtje. Ju ftoj t'i nderojmë me një minut heshtje.

**z.Daut Xhemajli:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Pas Shtëpisë së Kulturës një prishje e kanalit, një objekt është i madh, nuk e di çfarë leje ka, krejt hapësira, oborri është i zanun edhe tash ish prish kanalit edhe deviju kanali, e prish trotuari. Kush i ka dhanë leje edhe a e ka pa kush këtë farë punë.

**Drejtori z.Skender Ahmeti:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, për nënkryetarin, për asamble dhe bordin e drejtoreshave. Pyetjes së Mirlindës dashta me ju përgjigj, për shkak se nuk është ajo shumë Mirlindë, po janë diku afër 90.000 euro që operatori e ka fitu për me vendosur sinjalistikën në Komunën e Vitisë dhe është tu punu. Për fat këto ditë është koha me shi e si të qetësohet koha operatori do të jetë prapë në Viti. Sa i përket zëbrave afër shkollave, na e kena mëndu zgjidhjen ma të mirë se sa zëbrat, duke vendosur disa pjesëza të vogla që ndriçojnë apo reflektojnë edhe natën, është një pengesë komunikacioni për me ngadalësu shpejtësinë para shkollave, këtë shumë shpejt do ta bajmë, në Pozheran e kemi ba dhe kemi vendosur nënkalinimin apo zëbrat afër shkollave, po ne do t'i vendosim sidomos te fshatrat ma të mëdhaja, si në Skifteraj, Beguncë, Smirë, Pozheran, se ndoshta nuk mundemi për krejt fshatrat qato pjesë që ndriçojnë edhe natën. Ndërsa sa i përket pyetjes së Dautit, na dje e kemi pa aty që ka punu, inspeksioni do ta inspektoj këtë çështje, ai ka deviju, është largu pak me tepër, e kemi pa dhe besoj që nëse nuk ka leje do të ndërpritet ajo punë, se ai gjatë punimeve që ka ba e ka prish vendkalimin për trotuarin e këmbësoreve dhe ne do ta detyrojmë që shpejt me ndreq ata. Faleminderit!

**Drejtori Z. Qahil Sinani:** Përshëndetje për të gjithë, kryesues, nënkryetar! Sa i përket pyetjes te dezinfektimit, unë nuk e di këto mjete sa janë nda e është dezinfektu vetëm shkolla në Drobesh, që nuk ka kushtu përmi 150 euro. Sa e di unë, ka pas dezinfektim edhe në çerdhe, e ku është ba edhe një renovim i brendshëm, dezinfektim nëpër shkolla, nëse është punu në gjimnaz, diçka nuk

kam njohuri për tjerat, është vetëm Drobeshi. Janë ndarë ato mjete po nuk janë hargju, nuk kanë qenë kështu, nuk janë kry tjerat e nuk kam njohuri.

**Drejtori z.Ibrahim Rama:** Po Mirlindë, është në planin dinamik të punës së Zyrës së Prokurimit, ku ky aktivitet lidhur me dezinfektimin në shkollë nuk ka ndodhë, nuk ka thirrje publike, nuk ka harxhim të buxhetit, është planifiku, d.m.th. në planin e punës të Zyrës së Prokurimit, konkretisht s'ka kurgja në këtë drejtim. Faleminderit!

**znj.Mirlinda Sadiku:** Atëherë pse u parapa kjo shumë, 9.900 euro nuk janë pak. A ka nevojë mu dezinfektu, normal që ka nevojë mu dezinfektu. Kjo është një moskoordinim total për planifikim edhe ekzekutiv. Nëse nuk është i njoftum drejtori i Arsimit, ma së pari shkolla jonë ka nevojë për dezinfektim, se është hapësirë e madhe, e mirëmbajtje edhe ambullanta ka nevojë d.m.th. 9.900 euro janë planifiku e pse nuk janë shpenzu. Edhe të çerdhja ku fëmijët mundën me qenë të atakum me viruse të ndryshme, se e dinë që aty ka fëmijë me s'mundje me infeksione të ndryshme, paret janë, nevoja është, pse mos mu ekzekutu?

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Me lejoni ta përsërisht kryesuesin, Bordin e Drejtoreve. Unë nuk do ta them atë se është seanca e fundit, falënderimi është që e kemi pas një bashkëpunim të mirë, ndërsa për angazhimin e juve nuk do të ju falënderoj, se u kanë obligim i juve që e keni marr prej qytetarëve. Ne sot e kemi aprovimin e buxhetit, unë e di atë rrugë, e di që sivjet është në plan të shtrohet me zhavorr në kompleksin e rrugëve, që është rruga për Cernel, prej Cernelit në Mogillë që do të jetë e asfaltuar. Çështja të cilën e ngriti këshilltarja e Vetëvendosjes tash po e quaj, të Zyrja e Prokurimit ka qenë një shumë e parapamë prej 9.000 e diçka euro, mua po më vjen mirë që e kana parapa dhe aty ku të jetë nevoja edhe do të intervenohet. A kemi nevojë për intervenime, janë personat përgjegjës që e konstatojnë atë dhe bahet dezinfektimi edhe të objekti të cilët kanë nevojë.

**znj.Mirlinda Sadiku:** I kam thy rregullat, pe shkeli rregulloren, veç se po ja përkujtoj nënkryetarit se kam qenë pjesë e Aleancës, kam dhanë kontributin aty ku nuk jam vlerësuar, aty ku u dashtë mi tejkalu parimet e mia. Jam krenare për kohën që ja kam kushtu, tash jam pjesë e Vetëvendosjes me plotë dëshirë. E dyta, sa i përket dezinfektimit të shkollës, e din drejtori, i ka shku procesverbali prej inspektoratit të arsimit kinse janë gjetë elemente bakteriologjike, ka pas nevojë për dezinfektim, procesverbali të ka ardh para një viti.

**z.Vehbi Rama:** Përsëritje për të gjithë! S'dashta me dal, se për katër vite kush ka dashtë ju ka ndihmu, kërkesat i kanë ngrit, mirëpo veç që u përmend Aleanca e fatkeqësisht kam mbet veç vet në Aleancë, ma besniku kam mbete në Aleancë. Ju uroj qytetarëve formimin e qeverisë.

**Drejtori z.Qahil Sinani:** Çfarë pune janë kryer nëpër shkollë edhe cilat punë janë kry të cilat po thotë Mirlinda, është gjynah me përmend, se s'ka nevojë për dezinfektim shkollë në Skifteraj. Unë nuk e di ku ka shkollë ma të pastër, se kur është bërë renovimi i të gjitha nyjeve sanitare, e asnjë shkollë prej 38 objekteve shkollë që janë nuk kanë nevojë për dezinfektim, përpos shkollës në Drobesh që kanë kërku edhe e kemi kry. Pse s'pe përmendin gjimnazin, se çfarë punimi është bërë atje, pse spi përmendi renovimet e shkollave tjera, që janë derdh mjete të shumta në ato e jo mu na të një dezinfektim këtu.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** I takoj një prej kategorive të cilët kurrë s'jam marr me vetvete, nuk e kam parim edhe të merrem me dikan tjetër, megjithatë Mirlindë ke mujt nashta me keqkuptu,

unë e kam thane veç një realitet, krenohem gjithëherë me te kaluarën time, nuk besoj që edhe në qatë hapësirë ka pas mundësi të bahet ma shumë. Ajo që dashta me thanë, kurrë mos e lidh çështjen individuale me çështjen grupore, se ke mujt me analizu, e aty i kem dallimet unë edhe ti.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** I falënderoj të gjithë! Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për mbledhjen e tetë të Kuvendit Komunal kemi parapare këtë:

## **R e n d i t e**

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e KK-së të Vitisë.**
2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit të buxhetit të Komunës së Vitisë për vitin 2018-2020.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm të parcelës Kadastrale me nr.1330-2 në zonën kadastrale në Gjylekar.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për iniciimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurt të pronës Komunale.**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e Planit të Punës të Kuvendit Komunal.**
6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë, për vitin 2018.**
7. **Informatë nga Drejtoria e Arsimit për fillimin e vitit të ri shkollor.**

A ka dikush rreth rendit të ditës?

**z.Mirlinda Sadiku:** A ka mundësi pikën për Drejtorinë e Arsimit me vendos në pikën numër tre, nëse bënë, se kam disa obligime e nuk po muj me nejt deri në fund.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** E hudhë ne votim kërkesën e Mirlindës. Kush është që të ndryshohet pika e shtat e rendi te ditës te del ne piken numër tre te rendit te ditës? Konstatoj që u be ndryshimi dhe miratohet ky rendi i ditës me këto pika.

### **Pika e parë**

1. **Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e Kuvendit Komunal të Vitisë**

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hap debat rrethe procesverbalit.

**z.Bekim Azizi:** Kam disa vërejtje te procesverbali, sepse në mbledhjen e kalume e kemi pas një diskutim bajagi edhe me disa gjera që janë kanë të pajeshme nga ish kryetari dhe ishe nënkryetari i Komunës, që nuk janë paraqit asnjani këtu. Unë mendoj që duhet te plotësohet me ato diskutime, ku nënkryetari ku i qunë, unë kam diskutu me rrugaq, ato janë hek komplet.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** A ka dikush tjetër ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? E hedh në votim procesverbalin. Me votat e të gjithëve u miratua procesverbali.

### **Pika e dytë**

2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit të buxhetit të Komunës së Vitisë për vitin 2018-2020**

**Drejtori z.Ibrahim Rama:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Draft buxheti për vitin 2018 dhe projeksionet për vitin 2019-2020 është një nder dokumentet me kryesore që miratohet nga ju të nderuar këshilltar. Procesi i përgatitjes se këtij draft buxheti është mjaft i gjatë, ka marr një kohë mjaft të gjatë, ka pas debate të ndryshme, aktivitete të ndryshme. Gjatë këtij procesi me ardhë te një draft i mirë, të sakte ne bazë te nevojave dhe prioriteteve te qytetarëve të Komunës së

Vitisë, ne i kemi organizuar 26 dëgjime publike, e ku e kemi bërë një databazë për kërkesat e nevojat që janë për qytetaret e Komunës sonë. Unë e di edhe po e thamë, që ky buxhet nuk mjafton me i plotësua të gjitha kërkesat që kanë banorët e Komunës së Vitisë, pra, vlera e saktë e buxhetit për vitin 2018 është 10 milion e 847 mijë euro. Në këtë buxhet janë dy burime kryesore që do ta plotësojnë këtë buxhet, burimi kryesor është të të hyrat nga grandit nga qeveria e nivelit qendror d.m.th. grandit qeveritar që shpërndahet neper të gjitha komunat në baze të kriterëve dhe kjo shumë për vitin 2018 kap vlerën prej 9 milion e 800.000 euro, d.m.th. kjo shumë është që financohet prej grandit të përgjithshëm, kurse pjesa tjetër e burimit të financimit të këtij buxheti janë të hyrat vetanake që në vitin 2018 në planifikimin që ka ardh nga Ministria e Financave e kena për obligim si Komunë t'i grumbullojmë 10 milion e 47.000 euro që në total këto dy burime të financimit e përbejnë buxhetin e përgjithshëm të Komunës së Vitisë, prej 10 milion 847.000 euro. Që mos të ju marr kohë më shumë, materialin e keni pranuar me kohë për pyetjet dhe sqarime jam në dispozicionin e juaj.

**znj.Vjollca Kadolli-Halili:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Propozim buxheti për vitet 2018-2020 është inkurajues për të ardhmen e Komunës së Vitisë. Unë në emër të grupit të këshilltarëve të LDK-së ju përgëzoj për planifikimin e drejtë që keni bërë gjatë këtyre viteve, e cila ka rezultuar me realizim të planit pothuaj që qind për qind çdo vite, vlerë që ka treguar në vazhdimësi seriozitetin e kësaj qeverie. Gjithashtu përgëzoj drejtorin e Financave për organizimin e 26 dëgjimeve buxhetore në lokalitete të ndryshme dhe me grupet e interesit. Nga ky dokument shihet se do të kemi rritje nga të gjithë sektorët ku vlera prej 828 mijë vetëm për vitin 2018 tregon se vërtet do të realizohen edhe premtimet të cilat janë dhënë si dhe do të përmbillet edhe cikli infrastrukturor në Komunën e Vitisë, kurse vitin 2019-2020 do të fokusohet drejtpërdrejt në rritjen e mirëqenies sociale të qytetarëve. Ky buxhet për këto tri vite do të përmbyll edhe renovimi dhe ndërtimin e shkollave të cilat kanë mbetur sidomos në ato fshatra ku shkollat janë me të vjetra, si p.sh. në Drobesh. Gjithashtu ka pas dhe ka me pas rritje të investimeve në shëndetësi, ku jemi dëshmitar që ka ndryshu cilësia e shërbimit në shëndetësi.

**z.Samet Idrizi:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Para vete kemi një propozim vendim për aprovimin e buxhetit të Komunës së Vitisë për vitin 2018-2020. Propozim i imi është, që të hyrat vetanake komunale të projektohen të parat për një 0.5 % apo 1% ma të mëdhaja të krahasuar me vitin 2017. Mos të lejojmë të behet një shprehi e keqe, ku ne planifikojmë vitin paraprak me shumë e vitin vijues pak më pak, se nuk është mirë kjo në zhargonin e ekonomisë. Te neni tre, personalisht unë edhe grupi i PDK-së, mënojmë, se struktura e ndarjes së shpenzimeve duhet të jetë më ndryshe. Te mallrat dhe shërbimet është mirë mu bërë një ulje, që me be investime kapitale me shumë shpenzimet komunale 200 mijë e 862 euro, është mirë edhe këtu një pjesë me marr edhe të subvencionet e transferet, në mënyrë që investimet kapitale të rriten. Pse në qytet të Vitisë kemi akoma bukur shumë lagje të cilat nuk kanë kanalizim. Kanalizimi për mu mendoj, që për qytetaret e Vitisë është nevoja më parësore. Tek kategorizimi i buxhetit për vitin 2018, kategoria për subvencione dhe transfere, unë mendoj që të Bujqësia dhe Pylltaria e Zhvillimit Rural, 33 mijë euro shumë një shumë e vogël, është shumë më mirë me i dhënë prioritet Bujqësisë dhe Pylltarisë se sa Kulturës, Rinisë e Sporti, tu e ditë që Vitisë është një vend rural bujqësorë. Te ndarja e buxhetit, rregullimi i kanalizimit dhe gropave septike, këtu besoj dhe duhet të dijet se cilat lokalitete në kemi me investu saktësisht këto 182 mijë euro, ku kanë me shku, se këtu janë dhanë si formë të përgjithshme e nuk po e dimë ku kanë me shku. Kërkesa e imja është, që të rregullimi i kanalizimeve të rritet kjo shumë minimumi të bëhet dikun 300 mijë euro edhe mundësisht të intervenohet nëpër pozicione të tjera. Propozimi i imi konkret është, që rruga "Ilvi Demiri", ku ka mbi 40 shtëpi, është një lagje ku ka asfalt, ka ujësjellës po nuk ka kanalizim. Të kihet parasysh

dhe te jepet prioritet ne vitin e ardhshëm, që ky kanalizim të kryhet. Kam kërkesa të qytetarëve, rruga “Sejdi Hebibi” i ka dikun 40-50 shtëpi, është rrugë që lidhet menjëherë prej pompës se Alidemve, një rrugë që është e pa asfaltuar, 400 metra rrugë është në qytet të Vitisë, duhet t’i jepet gjithsesi prioritet. Projektet investime për vitin 2018 që kapin shumën 2 milion e 213 mijë euro duhet të rriten, dhe si përfundim duhet të emërohen të gjitha lokalitetet se çka kemi me punu.

**z.Baki Nebiu:** Përshëndetje për të gjithë! Te ky propozim dua të ndalem, direkt te kërkesat dhe propozimet e Kuvendit si dhe miratime që i kemi bë nga ky Kuvend e ku asnjëher nuk po përfshihen në këtë buxhet. Konsideroj që miratimet që jenë bë nga ky Kuvend duhet të merren parasysh dhe duhet të hinë në secilin plan buxhet të vitit që vjen, si p.sh.: ne nga ky Kuvend kemi miratu strategji për personat me aftësi të kufizuara, unë nuk e pash në buxhet që e keni nda një shumë për këtë strategji. Te plani i mobilitetit dhe është plani i komunës për mbrojtjen ndaj zjarrit, që te tri këto që duhet të përfshihen në këtë buxhet, sidomos strategjia për personat me aftësi të kufizuara konsideroj që është shumë e nevojshme në Komunën tonë. Te projektet investive publike te vitit 2018, ne emër te grupit tim të partisë, por konsideroj që edhe ne emër të juaj, ne duhet t’i thomi jo njëherë e përgjithmonë kësaj mënyre te projektimit te buxhetit te Komunës se Vitisë, jo që jemi kundër projekteve, por jemi kundër kësaj mënyre e cila po kalon prej këtij Kuvendi që tri vite me radh, e ky viti është i katërti. Konsideroj që çdoherë kemi bë kërkesë, që kodet për projekte të jenë të specifikuar, se cilat rrugë napër fshatra, se cilat kanalizime napër fshatra, se cilat shkolla, cilat ujësjellsa kane mu rivitalizu dhe asnjëherë nuk e keni ndëgju për mi nda këto kode. Te projektet konsideroj, që asfaltimi i rrugëve rurale kjo duhet te ndahet ne cilat rrugë keni me asfaltu. Unë konsideroj që ka qenë kërkesë edhe prej këshilltarit Bislimi me herët, që është nevojë dhe rendësi e veçantë, që rruga mbi Kabash te asfaltohet, pasi që i ndimon biznesit dhe turizmit ne ato vende dhe asnjëherë as nuk e dimë a do te intervenohet në atë rrugë dhe as cila do te intervenohet. Rregullimi i kanalizimeve dhe gropave septike. I nderuar drejtor, nuk e di a keni dal në teren, por në këtë kod duhet me fut edhe ndërrimin e kapakëve te kanalizimeve, pasi që disa vende janë ndërru disa vende jo. Kapakët e betoni që kane mbet po shfaqin shume probleme. Rregullimi i hapësirave gjelbëruese publike, që katër vite e kame ngrit një çështje për rregullimin e hapësirave gjelbëruese ne fshatin Kabash, pavarësisht të gjithë atyre banorëve që janë angazhu për me e rregullu at me te hyrat e veta, ndërsa ju nuk keni intervenu asnjëherë, pavarësisht se gjithmonë keni than që do te intervenojmë ne atë hapësirë gjelbëruese ne Kabash, asnjëherë nuk keni intervenu. Duhet te ndahet buxhet për mirëmbajtjen e parqeve, pasi që janë disa parqe shumë të bukura, mirëpo mirëmbajtja ju mungon. Renovimi napër shkolla, është mirë te ceket cilat shkolla kanë mu renovu. Unë konsideroj që ne si këshilltar jemi për buxhet për miratimin e buxhetit, por jo në këtë mënyrë.

**z.Bislim Bislimi:** Përshëndetje për te gjithë të pranishmit! Edhe kësaj radhe VV nuk e përkrash dhe është kundër këtij buxhetit te Komunës. Qeverisja lokale gjate gjithë këtyre viteve asnjëherë nuk ka sjell para këtij Kuvendi një plan apo planprogram orientimi i mjeteve ka qenë kultura dhe ne projekte ku zakonisht kanë shërbyer si dekor apo thanë që kemi punuar për te fituar përshtypje para qytetarëve, kryesisht për te rritur votat për mandatin e ardhshëm. Nuk ka plane për zhvillimin apo projekt zhvillimore, apo ndonjë aktivitet ekonomik edhepse buxheti për vitin e ardhshëm do te jetë dukshëm ma i madh se ky, sepse gjatë gjithë kohës se kësaj qeverisje nuk i është kushtuar rendësi apo ndihmë kategorive që kane nevojë ne këto koha krize, kur shumica e popullatës jeton me kushte të mjerueshme dhe dëshpëruese për shkak të papunësisë së lartë, nuk janë ndimuar të pa punët përveç me premtime boshe të atyre dhe të liderëve të tyre. Në këtë buxhet nuk parashihet asgjë për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara e mos të flasim për kategoritë e përndjekura, të burgosurve politik, të veteranëve, invalidëve të luftës, madje as familjeve të

dëshmore, kategori këto që kanë qenë të sakrifikuara me së shumti për kotlluqet dhe pozitat që sot i gëzoni ju. Shoqata e të burgosurve politik për katër vite ka marr vetëm 1200 euro nga buxheti i Komunës, mjete këto që nuk mjaftojnë as për mirëmbajtje të zyrës e leje ma për ndonjë vizitë apo ndonjë shërbim tjetër që duhet t'i kryhet atyre njerëzve me vite të tera, edhe paraluftës edhe pas luftës kanë qenë të përndjekur, të nënçmuar, te shtypur, të injoruar. Rrugët e fshatrave malore, si janë Debelldeu, Mjaku, Samakova etj, nuk kanë rrugë dhe infrastrukturë për të bë të mundshëm kthimin e banorëve të shpërngulur për derisa ne Viti shtrohet asfalti me një rrugë nga dy herë. As sistemi i Shëndetësisë e Arsimit nuk është me mirë. Prandaj nuk jam për kalimin e këtij buxheti.

**z.Mirlinda Sadiku:** Theksin e veçantë e kisha vendos tek mbikëqyrja e projekteve, dhe hartim te projekteve. Vetëm këtë vit Komuna e Vitisë ka shpenzu rreth 20 mijë euro për mbikëqyrje të projekteve investive, ndërsa për hartim të projekteve ka investu rreth 62 mijë euro, për afërsisht kjo shumë është shpenzu edhe vitet paraprake, mirëpo është për tu habitur fakti se asfaltet që po shtrohen po duhet mu harrnu shpeshherë, e kame dokumentu edhe se seancat e radhës te kalume, vlen te cekte asfalti i Tërpezes, Lubisht, Zhiti dhe disa trotuare. Po ashtu janë dokumentu nëse Komuna i shpenzon gjithë këto të holla brenda vitit, e ka zyrën e mbikëqyrjes se projekteve, zyrën investimeve, pse po ndodhin këto punë kaq jo kualitative, edhe pse në vitin 2018 gjitha rrugët të asfaltohen, prandaj taksat e qytetarëve po orientohen në investime, po ato investime nuk po i rezistojnë kohës, madje as një vit masi po shtrohet ajo udhë. Çështja tjetër që kisha cek për këtë buxhet, po ashtu nuk është parapa për mu përkrah gratë lehona. Drejtori e ceki se janë mbajt 26 dëgjime buxhetore, ka qenë kërkesë e grupit të grave e artikuluar nëpërmjet zonjës Xhilsime Qamili, që të përkrahen këto gra lehona me nga 100 euro. Rastet sociale, kemi bë një kalkulim, ka qenë ngarkesë për mu përkrah të gjitha gratë lehona, edhe pse Ferizaji e ka përkrah dhe e ka parapa në buxhet, mirëpo Vitia ende nuk gjet hapësirë buxhetore me i përkrah këto gra. Po ashtu ka qenë kërkesë e protokolume e grupit të grave, që të përkrahen 5 individ, tre të gjinisë femërore e dy të gjinisë mashkullore. Për të ju paguar mësimi jo formal në kuadër të shkollës se mesme profesionale që organizohet, as kjo nuk është parapa. Po ashtu ka kërkesa, ekziston edhe padia e cila është bë nga sindikata e bashkuar e arsimit ne adresë të drejtorisë, ku kjo padi është nga 37 mësimdhënës të cilët nuk e kanë marr pagën jubilarë, dhe sipas ligji, te neni 7 pika 4, Ligjit Parauniversitar, ku thuhet “punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblimin jubilar”. Shuma e përgjithshme e kalkular për 37 mësimdhënës është 92 mije e 500 euro, as kjo nuk është parapa në buxhet. Është obligim i Komunës që te paguhen këta mësimdhënës, prandaj potencoj që 500 mijë euro parashihen investime kapitale për vitin 2018, nuk është parapa as nuk shihet kodi buxhetor, e vetmja është që vitin e ardhshëm është, vetëm kur ti shofim ne lajme se ku po investohet. Është e rëndësishme të potencohet se te shkolla e mesme profesionale është mizerje, është në gjendje shumë të keqe, aneksi i shkollës aty ka nevojë për investim imediat, sepse ujërat e shpeshta shpeshherë kanë dal në korridore dhe aty janë të vendosura 6 punëtori. Prandaj aty mesojnë femitë e tanë e ardhmja jonë.

**z.Sami Demelezi:** Përhëndetje për te gjithë të pranishmit! Sa i përket këtij materiali, konsideroj që është bë një punë e mirë, këtë jo vetëm që e thamë unë pas 26 dëgjimeve buxhetore po këtë po e thotë OSBE-ja me një takim që kishim për transparencë me datën 20.09.2017 në Hotel “Sharr”. Përfaqësuesja e OSBE-se e tha që jemi të parët në nivel vendi për dëgjime buxhetore, duke pasur fakti që ky buxhet është përpilu. Duke pasur parasysh këto dëgjime buxhetore, mendoj që kërkesat e dalura nga dëgjimet buxhetore janë shqyrtuar dhe përpiluar në këtë buxhet, ku kemi parasysh që kemi një ngritje të buxhetit prej 822 mijë euro, shumë që konsideroj që do të ndihmon në ecjen përpara. Prandaj si i tillë konsideroj që është një buxhet i mirë.

**z.Ekrem Abazi:** Përshëndetje për të pranishmit! E kisha përshëndet Nuren dhe Hasani që pas 17 vite interesohen për një rrugë atje që e lidhe Stubllen e Ulët dhe Godenin, ju falënderoj që ju ra në men tash mas 17 viteve, edhe pse vonë, është shumë mirë. Sa i përket projekteve investive publike për vitin 2018, e pash që ka shume projekte, shuma e parë është caktuar, psha e pash te asfaltimi i rrugëve rurale 560 mije euro, rregullimi i kanalizimeve dhe gropave septike 182 mije euro rregullimi i rrugëve me zhavorre 145 mije euro, ndriçimi publik 291 mije euro shuma bejagi e madhe po nuk pash as nje vend që jane specifiku keto dmth këta njëze nuk e bejn specifikimin per shkak me i knaqë te gjith qytetaret kushe te shkon me kerku diqka këta thojn po kjo ka mu bë une kisha kerku që kjo shume mu specifiku psh. Rruhet rurale kane mu shtru ne kete vende krej mu percaktu, kërkoj që kjo pik mos te votohet te shtyhet ose te thirret nje senc tjetër e te specifikohen.

**z.Bekim Azizi:** Përshëndetje për te gjithë te pranishmit! Ky propozim që ka ardh nuk dallon nga buxhetet tjera. Besoni që qekjo faqe vetëm e kishin nda në fund, se e njëjtë është me të vitit të kaluar, vetëm vlera ka ndryshuar. Po me vjen interesant qetu, 15 dhe 17, përcjellne renovimi napër shkolla dhe riparime napër shkolla, e dyta ka qen edhe vitin e kaluar; asfaltimi i rrugës Germov – Gushice janë kanë 40 mijë euro tash 1 qind e 1000 euro; rregullim te kanalizimeve dhe rregullim te ujësjellësve 55 mijë euro. Merrne me men sa ujësjellsa kemi mi kry. Rrugët rurale nuk janë specifiku, ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimi publik: p.sh: cilët kane mu bë? Është mirë të specifikohen se cilët kanë me u rregullu, duhet te dimi ne dhe qytetaret se ku po investohet. Nuk keni nda asnjë mjet për planin strategjik që e kemi miratu na për persona me aftësi te kufizuar, qaj plane kërkon mjete të ndahen. Plani i mobilitetit që planifikojshi, rrugë ne mes te ndërtesave, lidhje te rrugëve asnjë mjet nuk e keni nda. Kemi miratu rregullore për mirëmbajtjen e varrezave, na e dimi që shumë varreza të vjetra çka janë bë, ka nevojë edhe një riparim të bëhet te varrezat e dëshmorëve ka qenë dash të ndahet buxhet, ka qenë dashur të ndahen mjete për ndërtimin e shkollës në Drobesh, ka nevojë ajo shkollë; turizëm kurgja nuk keni nda; u kane dashtë me mendu për kontratën kolektive për tri pagat e mësuesve ata që dalin në pension është obligim i komunës. Nuk jemi kundër buxheti, por duhet të specifikohen. Unë them që ky buxhet të mos miratohet sot ta shtymë edhe një seancë tjetër të specifikohen. U kanë në Smirë projekti i kanalizimi që kurrë nuk e keni kry, janë kanë dy gropa septike, kurrë nuk e keni ndreq.

**z.Taip Alidema:** Përshëndetje për të gjithë koleget! Ne në fillim ju kemi thënë se do të ju ndihmoj si qeveri komunale, vetëm punoni sa me mirë për qytetaret. Për punët që i keni bë i keni e ju kemi bë pëlqime napër facebook-a, mirëpo përveç këtyre punëve te mira qe i keni bë keni pasur një përkushtim të mirë në ambient, në pastrim të lumit, të rrugëve, mirëpo ajo që tërë kohen ne si Parti Demokratike ju kemi dhënë vërejtje ka qenë menjëherë në vitin e dytë, tretë dhe të fundit, prapë u përsërit kjo, që d.m.th. që gjysma e buxhetit vjen me pëlqy, me qu dorën ne e mos me ditë ku kanë me shku ato mjete, p.sh.: e përsëritëm prapë edhe këshilltarët e pamvarur e te varur, kryesuesit e grupeve, mirëpo me të vërtetë minimum 887.000 euro nuk dihet se ku kanë me shku, ndërsa shumë me vend kjo qe thotë 101.000 kane me shku ne rrugën Germovë-Goshicë, p.sh.: si na me miratu një buxhet kur nuk e dimë ku ka me shku ai buxhet a në rrugë a në kanalizim, krejt janë të rëndësishme, mirëpo s'paku te ish emëru kjo. Kjo është skandaloze drejtor, ndoshta ti s'ke guxu mej a vnu emrin, ndoshta e dini ju po neve duhet me naj tragu e qytetarëve duhet me jav tregu se cilat rrugë kanë mu shtru. Pse si erdh reni shkollës se Pozheranit kurrë mu ndërto edhe kur e ka propozu deputeti i Vetëvendosjes se kane përkrah e nuk shkohet ne buxhet qendror apo lokal kena me ba kaq po ja vnu emnin ku ke me be. Për raste ne s'jemi pajtu, kemi pas vërejtje e kritika, mundeni me thanë se e keni për vota po ai qe ka punu katër vite e s'ka prit ne muajin e fundit me punu për vota, e ne fillim i kam thane qe ne muajin e fundit na ke opozitë e katër vite na



ke për me punu, mirëpo ju keni punu po vërejtje ka ne punën e juaj. Mua po me vjen keq po ajo që më ka brengos mua si punëtor shëndetësor, unë e di që ka pas nevojë ndoshta për 10 motra infermiere, na i kemi pas dy mjeke e dy motra me Karitas, ama unë nuk e kuptoj krejt kush u paraqit krejt mi pranë me kontrate mbi vepër, ndoshta kjo është shkelje. Unë s'kam mujt edhe një mjek të vetëm me pranë me kontrate mbi vepër, po kur t'i vje rendi e kur te o mundësia duhet mu ba njëfar rendi, ju i keni pranë 60, po te jeni te bindur edhe 300 ju kanë idhnu, se ka plotë që se kanë kuptu kur ka dal konkursi, konkurs intern u kanë ai e jo konkurs publik. Mua po me vje keq, unë kam konsideratë, unë ju duartrokiti për angazhimin, e di që keni ba atë çka keni mund mirëpo nevojat janë shumë ma të mëdhaja. Unë ju bashkohem asamblistëve, që mundësisht na thirni edhe njëherë, emëroni këto rruge ta dimë se cilat rrugë kanë mu shtru, cilat kanalizime kane mu rregullu, Unë kam prit shumë ma shumë prej kryetarit të Komunës, prej Qeverisë, për mua jo pse jemi në fushatë po ky kryetar nuk ja ka arrit mu kanë kryetar i krejt qytetarëve të Vitisë, kjo qeveri nuk ja ka arrit mu kane qeveri bindëse që meriton edhe një mandat. Unë ju uroj suksese në garë, uroj edhe kandidatët për kryetar edhe ju asamblistët të jeni fer, të tregojmë një kulturë, po synimi nuk flet ashtu. Kaq!

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Faleminderit Taip. Meqë e përmendi shkollën e Pozheranit, jam i obliguar të bëjë një sqarim, sepse qeverisja e z.Taip, së bashku me ish ministrin e tij Enver Hoxha, ju ka pas premtu qytetarëve të Pozheranit, që pranverën e vitit 2008 do te fillon shkolla në Pozharan, por që nuk ka filluar pasi ministri Hoxha ju ka premtuar prapë, mirëpo fatmirësisht ne vitin 2016 erdh një kryeministër ne bashkëpunim me partin e Taipit, ku filloj ndërtimi i shkollës e ku e ka planin dinamik dhe jam i bindur shumë që do te ndodhë, do te ndërtohet shkolla në Pozheran.

**z.Taip Alidema:** Ajo çka ka ndodh me shkollën e Pozheranit është me të vërtet një tragjikomedi. Shkolla e parë shqipe e vitit 1905, vazhdimësia e saj, shkolla e tretë ndërtimi i hershem, gjendja e saj, të jeni të bindur se shumë herë prind, qytetar kane mendu ose me i ndal fëmijët ose me djeg at shkollë, i erdhi fundi, mirëpo unë edhe për at ministër të atëhershëm e kam than, por unë prapë po kërkoj që ky buxhet që është prej 1 milion, gjysma e buxhetit të emërohet. Nuk e di a ka mbet në Kosovë ndonjë shkollë pa u ndërtua nëse kanë qen mbi 500 nxënese, kjo është e pa falshme.

**z.Daut Xhemajli:** Përshëndetje për të gjithë! Unë nuk jam planifiku me planifikimin e buxheti te të hyrat dhe kam pas vërejtje e sugjerime, po tashti nuk po muj me kuptu. Pajtohem me emërtimin e projekteve, emërtimet e projekteve të jenë me të sakta, specifikim më të saktë, planifikimin më të mirë etj. Po qe ky buxhet i propozum që mendoj duhet mu miratu, përmbajtësish nuk muj mu pajtu se ky buxhet me së miri ju hap rrugë partive që pretendojnë me ardh në pushtet për me bë një buxhet ndryshe dhe me e planifiku ndryshe ose me e realizu këtë buxhet më mirë e kanë qel, se ku dojnë me i qu mjetet qyshe dojnë me i planifiku mirë. Te projektet kapitale duhet emërtimi i saktë, duhet projekt i saktë, duhet me një formë edhe mbikëqyrja. Unë pajtohem që për informim tonë, që këshilltarëve të ardhshëm me i pas brenda projekteve emërtimet e secilës rrugë, rrugica, ku ka edhe sa metra i kanë.

**z.Ali Bajrami:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Ky draft buxhet është si dokument që i mundëson funksionimi normal Komunës së Vitisë. Në këtë draftë buxhet me gëzon që kemi rritje të buxhetit prej 9 milion e 19 mijve që ka qenë 2014, vitin 2018 është 10 milion e 847 mijë, që kemi përfaqësish rritje për 2 milion euro. Krejt kjo po bëhet për projekte kapitale. E për krahi dhe jam pro këtij propozim vendimi.

**z.Vehbi Rama:** Edhe unë pajtohem që ka shumë që nuk janë të specifikume ku behet investimi në 2018, 2019. Siç e dini, të gjitha drejtorit janë të njoftume ku janë rrugët me të frekuentume. Në

Viti kanalizimi mungon, te rruga “Rexhep Bislimi” që katër vite rregullisht kam kërku, është mjerim kanalizim, nuk ka që ende ka grop septike, që faktikisht Drejtoria e Inspeksionit e dinë, është dal mbi sipërfaqe të tokës, aty kundërmon erë, aty kalojnë mbi 1000 nxënës, du me ditë kur fillon kanalizimi në këtë rrugë.

**z.Hasan Alia Nënkrjetar:** Ky draft buxhet është i përgatitur ne mënyrë me të mirë të mundshme. Nëse thuani që kem pas keqpërdorime të buxhetit, dilni, janë mjetet e informimi, dilni me fakte, hiq nuk është problematike për neve, se unë e di që kemi qeveris në mënyrë më të mirë të mundshme. Krejt investimet kanë mu bë në Komunën e Vitisë, nuk dalim jashtë Komunës së Vitisë. Kush do ti gëzon këto investime, qytetaret e komunës se Vitisë. Gjithkund ne botë ka mirëmbajtje të rrugëve, edhe shtetet perëndimore edhe unë jam qe duhet ta shtojmë cilësinë e mbikëqyrjen, po megjithatë në kuadër të kushteve tona, na i kemi mundësit që i kemi pas. Taipi tha skandaloze, unë nuk e di qyshe e kupton ai skandaloze, mu me te vërtet me habiti. Dua t’i falënderoj këshillat e fshatit të cilët punoj pa pagesë, e ku kanë qenë shumë aktivë dhe nuk ka rrugë as pjesë e ndriçimit publik që e kemi fut në implementim pa pëlqimin e tyre. Konsideroj një mekanizëm shumë i rrespektum ne koordinim me ta që është bë. Ekrem, më ka ra ndërmend për Stubell edhe me herët, por u përgjigja se është në projekt tani dhe u deshtë me cek se e pata pyetje.

**z.Ekrem Abazi:** Edhe njëherë po te falënderoj, po pasi paska kalu projekti, d.m.th e paske kërku me vonë. Sa i përket kilometrave që thave, nuk po me interesojnë kilometrat mu, po më interesoj 800 metra qetu edhe 200 qetu bëjnë një kilometër, mu po me intereson mu be specifikimi i asaj se ku ka me u punu.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Unë këtë propozim po e qes në votim: Kush është që të miratohet? Prezent janë 24 këshilltar. Kush është që te miratohet? 15 janë pro, kundër 7, apstenon 1, miratohet buxheti i Komunës.

Si pikë të tret të rendit të ditës kemi:

### **3. Informatë nga Drejtoria e Arsimit për fillimin e vitit të ri shkollorë**

**Drejtori z.Qahil Sinani:** Përshëndetje për te gjithë! Drejtoria e Arsimit me kohë i ka bë përgatitjet e nevojshme për fillimin e vitit shkollorë 2017-2018. Fillimi i vitit shkollor ka fillu me kohë sipas kalendarit të aprovuar nga MASHT-i. Unë e di qe informatën e keni pranuar me kohë, që mos te ju marr kohë më shumë, për pyetje dhe sqarime jam ne dispozicionin e juaj.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapi debat rreth kësaj pike.

**z.Sejdi Emimi:** Përshëndetje për të gjithë! Pyetje, kam ndëgju qe janë hap dy parashkollorë, dua ta di ku dhe a përmbushen kushtet. Pothuajse napër të gjitha shkollat e Vitisë kemi probleme me elementare, as fletë për fotokopje nuk kemi, as ngjyrë për fotokopje nuk kemi. Te pushimet e lehonisë, ti duhesh me i parapa pushimet e tyre, po bëhet nga një muaj nuk po mbahet procesi mësimor shkaku i mos menaxhimit të mirë. Te shkolla ku punoj unë, tri javë nuk kemi pas arsimtar të Biologjisë. Dokumentacioni pedagogjik ka ardh me vonës, por jo ndoshta për faj tanin.

**Drejtori z.Qahil Sinani:** Ende nuk është obligative se secila shkollë të ketë parafillor, ngase që Ministria e Arsimit ende nuk e ka lëshu një udhëzim administrativ për këtë, prandaj me një nevojë shumë të madhe është hap ne Sadovinë e me një vend tjetër. A nevoja është te hapet ne te gjitha shkollat. Te mungesa e fletave, janë ardh tashti. Te pushimi i lehonisë, nuk kemi faj ne po ligji, nuk mundesh me e sistematizu asnjë njeri ne vend te punës nëse nuk hap konkurs edhe tash pushimet e lehonisë nuk lajmërohen vete punëtorët te cilat shkojnë, ku ato duhet me lajmëru te drejtori i shkollës, bile një muaj me herët.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** E falënderoj drejtorin për këtë informatë që naj ka sjell ne këtë seancë.

Si pikë të katërt të rendit të ditës kemi:

**4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm të parcelës Kadastrale me nr. 1330-2 në zonën kadastrale në Gjylekar**

**Drejtoresha znj.Fatbardha Emini:** Te nderuar te pranishëm para juve propozim vendimit për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm të parcelës Kadastrale me nr. 1330-2 në zonën kadastrale në Gjylekar. Ky propozim vendim vije ne saj te kërkesës së këshillit të fshatit, të cilët ju kanë drejtuar drejtorisë për arsye, se kjo rrugë shfrytëzohet më shumë se 30 vite nga banoret e kësaj lagje dhe prona në regjistrat zyrtar katastral është e menaxhuar nga AKP-ja dhe është një procedurë ligjore që duhet ta ndjekmi ne si organe komunale. Propozimin e kemi para vete, për pyetje dhe përgjigje urdhëroni.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapi debat rreth kësaj pike.

**z.Nuredin Lutfiu:** Unë e falënderoj Këshillin e Fshatit Skifteraj për propozimin e dhënë dhe për drejtoreshën e Gjeodezisë që na perkran, sepse unë jam inicues i këtij propozim vendimi.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Nëse nuk ka, atëherë po e qes në votim për miratim: Kush është që të miratohet ky propozim vendim ? Konstatohet se me vota të të gjithëve miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

**5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për iniciimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurt të pronës Komunale**

**Drejtoresha znj.Fatbardha Emini:** Qeveria komunale vazhdimisht gjatë këtij mandati është përpjek të sjell investitorë në Komunën e Vitisë. Ju e dini që Komuna e Vitisë ka mungesë të hapësirave publike apo të pronës komunale, të cilën Komuna e Vitisë e menaxhon, por ka edhe pjesë të cilat kanë resurse të ndryshme natyrore, që investitorët e huaj çdo ditë vinë edhe pyesin se ku mundën të investojnë dhe të rrisin numrin e punësimit në Komunën e Vitisë. Kuvendi Komunal është organi që jep lejen për fillimin e procedurave bazuar në Ligjin për Dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, andaj ju si Kuvend parimisht duhet të na jepni pëlqim për fillimin e procedurave për ankandin publik e procedura të tjera. Propozimin e keni pranuar me kohë, për pyetje dhe përgjigje jam në dispozicionin e juaj.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapi debat rreth kësaj pike. Pasi që nuk ka për debat, atëherë po e qes në votim për miratim: Kush është që të miratohet ky propozim vendim? Konstatohet se me një abstenim dhe te tjerat pro, miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

**6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e Planit të Punës të Kuvendit Komunal**

Kryesuesi z.Naim Pira e bënë prezantimin e këtij propozim vendim dhe hap debat.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Nëse do dikush për të diskutuar? Pasi që nuk ka për debat, atëherë po e qes në votim për miratim: Kush është që të miratohet ky propozim vendim? Konstatohet se me votat e të gjithëve miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të shtatë të rendi të ditës kemi:

**7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë, për vitin 2018**

Kryesuesi z.Naim Pira e bënë prezantimin e këtij propozim vendim dhe hap debat.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Nëse do dikush për te diskutuar? Pasi që nuk ka për debat, atëherë po e qes në votim për miratim: Kush është që të miratohet ky propozim vendim? Konstatoj se me votat e të gjithëve miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Ju faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë në këtë seancat dhe të gjitha seancat e tjera. Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:00 min.

**Procesmbajtësi:**  
**Fatlum Demiri**

---

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**  
**Naim Pira**

---